

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Martti Harsia si kryetar i kolegjit, gjyqtareve të EULEX-it Maria Giuliana Civinini dhe Anne Kerber dhe gjyqtareve të Gjykatës Supreme të Kosovës Marije Ademi dhe Nesrin Lushta si anëtare të kolegjit, në lëndën penale P nr 97/2001 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, kundër të pandehurit:

Besim Berisha i njohur edhe si Burim Dibrani, emri i babait _____, emri i nënës _____, mbiemri i vajzërisë së nënës _____, i lindur më _____ in _____ vendbanimi i mëparshëm rruga “ _____ ” nr. _____, ka mbaruar vitin e parë të _____, i _____, i _____ i Kosovës, në paraburgim fillimisht prej 03 gushtit 1999 deri më 20 mars 2000, aktualisht në paraburgim prej 27 gushtit 2008 (kur është deportuar nga Franca).

I akuzuar me aktakuzën e Prokurorit Publik të Qarkut të paraqitur më 22 nëntor 1999 në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, për veprat penale Vrasje sipas nenit 30 paragrafit 2 pikës 3 të Kodit Penal të Kosovës dhe Privim i kundërligjshëm nga liria, neni 63 paragrafi 4 në lidhje me paragrafin 1 të Kodit Penal të Serbisë i cili më vonë është ndryshuar më 24 nëntor 2009 për të përfshirë veprën penale Lënia në rrezik në shkelje të nenit 42 paragrafit 2 të Ligjit Penal të Kosovës në lidhje me nenit 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (1977), dhe më 11 dhjetor 2009 në mënyrë verbale e ndryshuar nga Prokurori Publik i EULEX-it për të reflektuar se data e arrestimit është 3 gusht 1999 dhe jo 2 gusht 1999.

I dënuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë më 16 dhjetor 2009 për veprën penale Lënia në rrezik në kundërshtim të nenit 42 paragrafit 2 të Ligjit Penal të Kosovës në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, me gjashtë (6) vjet burgim.

Duke vendosur mbi ankesën e paraqitur nga Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë dhe mbi ankesën e përbashkët të paraqitur nga avokatët mbrojtës Ymer Osaj dhe Mexhid Syla në emër të të pandehurit Besim Berisha, të dyja kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P nr 97/2001 të datës 16 dhjetor 2009,

Në përputhje me nenin 420 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (tash e tutje “KPPK”), pas seancës dëgjimore dhe seancës së këshillimit dhe votimit të mbajtur më 26 prill 2011, Gjykata Supreme e Kosovës në mënyrë publike shpall këtë:

AKTGJYKIM

Ankesa e paraqitur nga Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, refuzohet si e PABAZUAR dhe ankesa e përbashkët e paraqitur nga avokatët mbrojtës Ymer Osaj dhe Mexhid Syla në emër të të pandehurit

Besim Berisha, pranohet si e BAZUAR. Aktgjykimi i kundërshtuar i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P nr 97/2001, i datës 16 dhjetor 2009, ndryshohet dhe i pandehuri Besim Berisha, LIROHET.

Sipas nenit 103 paragrafit 1 të KPPK-së, shpenzimet e procedurës penale nën nenin 99 paragrafin 2, nënparagrafët 1 deri 5 të këtij Kodi, shpenzimet e nevojshme të të pandehurit dhe kompensimi dhe shpenzimet e nevojshme të avokatit mbrojtës do të paguhet nga mjetet buxhetore.

Në pajtim me nenin 426 paragrafin 3 të KPPK-së, për shkak të ndryshimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, paraburgimi kundër të pandehurit anulohet dhe përmes një aktvendimi të ndarë urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit.

ARSYETIM

I. Historia e procedurës

1. Më 2 gusht 1999 katër meshkuj kanë sulmuar M M dhe anëtarët e familjes së tij (vajzën e tij J , djalin e tij S dhe mbesën e tij V -tani A) në mbrëmjen e asaj dite në vendbanimin e tyre në Prishtinë. Si rezultat i sulmit gjatë të cilit sulmuesit gjithashtu kanë plaçkitur familjen, M M është lënduar rëndë dhe si pasojë ka vdekur para intervenimit të KFOR-it.

2. Ditën e ardhshme më 03 gusht 1999, pesë shqiptarë Kosovar janë kapur nga ushtarët e KFOR-it Italian në zonën e Deçanit. Në atë ditë J M e ka identifikuar Besim Berishën (i cili gjatë identifikimit ka përdorur identitet të rrejshëm pasi që emri i tij është Burim Dibrani) si njëri prej meshkujve i cili ka hyrë në shtëpi një ditë para 2 gushtit 1999.

3. Pas përfundimit të hetimeve më 22 nëntor 1999, Prokurori Publik ka paraqitur aktakuzë pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë kundër Besim Berishës për kryerjen e veprës penale Vrasje në kundërshtim të nenit 30 (2), pikës 3 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (tani e tutje LPK) dhe Mbajtje e kundërligjshme në kundërshtim të nenit 63 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste të Sërbisë (tani e tutje LPS).

4. Më 20 mars 2000 kolegji i përbërë prej pesë gjyqtarëve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë e ka liruar të pandehurin nga të gjitha akuzat dhe si rrjedhojë paraburgimi kundër të pandehurit është ndërprerë

5. Më 17 prill 2001, duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorit Publik. Gjykata Supreme e Kosovës ka anuluar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka kthyer lëndën në rigjykim.

6. Më 03 korrik 2001 procedura e rigjykimit ka filluar pranë kolegjit të përbërë prej pesë gjyqtarëve në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe ka vazhduar deri më 10 shtator 2001, mirëpo është shtyrë për një kohë të pacaktuar për shkak të mungesës së të pandehurit. Në të njëjtën datë kryetari i kolegjit ka lëshuar urdhrin për arrestimin e të pandehurit. Më 7 shkurt 2002 është lëshuar një urdhër-arrest tjetër kundër të pandehurit.

7. Më 24 dhjetor 2004 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP-ja) ka lëshuar një fletë-rreshtim ndërkombëtar kundër të pandehurit. I pandehuri është ekstraduar nga Franca dhe është marrë në paraburgim nga Policia e UNMIK-ut më 27 gusht 2008.

8. Më 12 maj 2009 Nënkryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ka lëshuar një vendim duke ia caktuar lëndën gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Vendimi është marrë në pazetë kërkesës me shkrim nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 17 prill 2009.

9. rigjykimi ka filluar më 28 korrik 2009 pranë një kolegji të përzier të përbërë prej dy gjyqtarëve të EULEX-it dhe një gjyqtari kosovar.

10. Më 16 dhjetor 2009 Gjykata e Qarkut në Prishtinë me anë të aktgjykimit P-97/01 ka shpallur të pandehurin Besim Berisha i njohur edhe si Burim Dibrani fajtor për veprën penale Lënie në rrezik në kundërshtim të nenit 42 (2) të LP të KSAK-së në lidhje me nenin 22 të KP të RSFJ-së dhe e ka dënuar atë me gjashtë vite burgim.

11. Aktgjykimi i lëshuar në gjykatën e shkallës së parë është kundërshtuar me ankesë nga Prokurori Publik i Qarkut dhe nga mbrojtja në emër të të pandehurit.

12. Prokuroria pretendon në shkelje të ligjit vetëm në pjesën e vendimit mbi dënimit. Mbrojtja kundërshton aktgjykimin në të gjitha bazat ligjore duke pretenduar një numër të shkeljeve të cilat do të shtjellohen më tutje.

II. Ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut

13. Në ankesë, Prokurori Publik i Qarkut parashtron se gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënim shumë të butë.

14. Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës pajtohet me konkludimin e Prokurorit Publik të Qarkut duke u shprehur se vendimi mbi dënimi është tepër i butë në krahasim me peshën dhe rëndësinë e krimin. Prokuroria parashtron se gjykata e shkallës së parë gjatë rigjykimit ka treguar se i pandehuri nuk e ka merituar që të trajtohet në mënyrë të lehtë mirëpo gjykata më vonë ka bërë gabim kur ka marrë parasysh së pari moshën e të pandehurit dhe së dyti kalimin e kohës nga momenti i incidentit. Prokurori ka theksuar se mosha e të pandehurit në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ofron fare zbutje. Vepra penale është kryer dhe planifikuar me gjakftohtësi dhe se ky nuk ka qenë veprim gjaknxehtë, i pamend, i një të riu energjik, rinia e të cilit ka kontribuar në mënyrën e

sjelljes së pakufizuar. Në lidhje me kalimin e kohës, prokuroria është e mendimit se i pandehuri ka qenë i arrati që nga 10 shtatori 2001 kur është lëshuar urdhri për arrest nga kryetari i kolegjit. Ai është deportuar nga Franca më 27 gusht 2008. Vonesa në vendosjen në këtë lëndë është shkaktuar nga i pandehuri dhe ai nuk duhet të përfitojë nga sjellja e keqe e tij dhe shmangia nga juridiksioni. Kjo lëndë e rëndë kërkon një dënim të rëndë sepse një njeri i moshuar është lidhur në qafë dhe më vonë ka vdekur; si rezultat një vajzë 8 vjeçare është traumatizuar. Prandaj, prokuroria është e mendimit se dënimi duhet të jetë maksimal dhe jo në nivelin e tri të katërtave.

15. Prokuroria pretendon se nëse gjykata e shkallës së parë ka gjetur rrethana lehtësuese, kjo domosdoshmërisht nuk e arsyeton dënimin e butë të shqiptuar ndaj të pandehurit dhe prandaj inkurajon Gjykatën Supreme të Kosovës që pjesërisht ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë duke propozuar rritjen e dënimit.

III. Ankesa e përbashkët e paraqitur në emër të pandehurit


16. Mbrojtja kundërshton aktgjykimin në të gjitha bazat ligjore duke pretenduar në shkelja esenciale të ligjit mbi procedurën penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të fakteve, shkelje të kodit penal dhe dënimin tepër të ashpër. Ankuesit kërkojnë lirimin nga akuzat ose anulimin e aktgjykimin të bashku me urdhrin për kthimin e lëndës në rigjykim si dhe ndërprerjen e masës së paraburgimit kështu që i akuzuari do të mund të mbrohej në liri. Avokatët mbrojtës në ankesën e tyre përmendin një numër të çështjeve të cilat e kanë shtyrë gjykatën në një vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të procedurës dhe ligjit penal. Në veçanti, mbrojtja pretendon si në vijim:

A. SHKELJE ESENCIALE TË DISPOZITAVE TË PROCEDURËS PENALE:

17. Shfrytëzimi i provave të papranueshme pasi që janë shpallur të papranueshme gjatë gjykimin të parë.

Mbrojtja pretendon në shkelje të nenit 364 (1), pikës (8) në lidhje me nenet 83 dhe 84 të LPK-së dhe Rregullores së UNMIK 2000/17 të marsit 2000, duke pohuar se provat e mbledhura nga KFOR-i në ditët pas ngjarjeve kriminale do të duhej të shpallehin të papranueshme dhe të veçoheshin nga shkresat e lëndës. Mbrojtja thekson se dëshmitarët është dashur të merren në pyetje nga gjyqtari hetues dhe jo nga personeli i KFOR-it. Deklaratat e mbledhura nga KFOR-i janë shpallur të papranueshme me anë të vendimit të formës së prerë gjatë gjykimin të parë, prandaj, sipas mbrojtjes çfarëdo reference e mëtutjeshme përbën shkelje të parimit *res judicata*. Përfundimisht, mbrojtja thekson se deklaratat fillimisht janë marrë në gjuhën italiane dhe më vonë janë përkthyer në gjuhën angleze dhe gjuhët vendore nga personat të cilët nuk janë të certifikuar për ofrimin e shërbimeve të tilla dhe të cilët nuk kanë dhënë betimin siç kërkohet me nenin 224 paragrafin 3 të LPK-së.

18. Mos respektimi i nenit 233 të LPK-së.



Në ankesë mbrojtja pretendon në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale përkatësisht Neneve 233 dhe 364 par 1 të LPP-së. Avokatët mbrojtës faktojnë se dëshmitari J M nga e cila u kërkua ta identifikojë një person së pari është dashur të kërkohet të japë përshkrimin e atij personi e pastaj të bëhet identifikimi.

19. Pakuptueshmëria e dispozitivit – arsyet janë të paqarta dhe kundërthënëse.

Paraqitësit e ankesës pohuan se aktgjykimi i kundërshtuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale siç përshkruhet në Nenin 364 (1), pika 11 e LPP-së, për shkak të faktit se dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është hutues dhe i pakuptueshëm, kundërshtues me arsyet e dhëna në të dhe nuk arrin të japë baza të mjaftueshme për fakte vendimtare.

B. VËRTETIMI I GABUAR I GJENDJES FAKTIKE

20. Mosmarrja parasysh e *ALIBISË* – kohës së arrestimit të të pandehurit

Mbrojtja sikurse edhe përgjatë procedurës penale mbrojti qëndrimin se i pandehuri nuk ishte i pranishëm në vendngjarje më 02 gusht 1999 kur familja M ishte sulmuar pasi që në atë kohë ai ishte i arrestuar nga KFOR-i Italian. Në mbështetje të *alibisë* mbrojtja bëri me dije mungesën e gjurmëve të gishtërinjve të të pandehurit në vendngjarje. Mbrojtja fakton se “Raporti i Ekspertit të Gjurmëve të Gishtërinjve” i UNMIK-ut i përgatitur nga K J. M pjesëtar i Policisë Mbretërore Kanadeze kishte arritur në përfundim se gjurmët e gishtërinjve në anën e brendshme të derës së ormanit në vendin e krimit nuk përputhen me gjurmët e gishtërinjve të të pandehurit.

21. Mungesa e lidhjes shkakore – rezultati i autopsisë nuk ka mundur të përcaktojë saktë shkakun e vdekjes.


Avokatët mbrojtës pretendojnë se autopsia e kryer nuk ka mundur me saktësi të përcaktojë shkakun e saktë të vdekjes. Sipas avokatëve mbrojtës ekzistojnë prova se tani i ndjeri kishte vuajtur nga shumë sëmundje që prej vitit 1991 dhe i kishte shpëtuar një sulmi të rëndë në zemër dhe se viktima ishte shtrirë kohë pas kohe në spital.

22. Fakti se pala e dëmtuar V M nuk e njohu të pandehurin në shqyrtim gjyqësor.

Avokatët mbrojtës theksoi se dëshmitarja V A nuk e njohu Besim Berishën në shqyrtim gjyqësor si njërin nga ata që hynë në shtëpinë e M më 02 gusht 1999.

C. SHKELJET E PRETENDUARA TË DISPOZITAVE TË LIGJIT PENAL

23. Shkelja e ligjit në pjesën e vendimit mbi sanksionin penal.



Sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, mbrojtja parashtroi se është i paligjshëm pasi që klienti i tyre nuk ka kryer veprat penale për të cilat ishte shpallur fajtor nga gjykata e shkallës së parë. Megjithatë, mbrojtja ka qëndrim ndryshe nga prokurori publik se një periudhë kohore prej gjashtë vjetësh burgim është shumë e butë kur merret parasysh se vepra penale për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor është e dënueshme me maksimum 8 vjet burgim.

D. ÇËSHTJE TË TJERA

24. Paraburgimi kundër të pandehurit.

Në fund mbrojtja ngriti çështjen e paraburgimit duke pretenduar në shkeljen e të drejtave të të pandehurit pasi që ai ishte mbajtur në paraburgim nga KFOR-i prej momentit të arrestimit të tij deri më 27 gusht 1999. Avokati mbrojtës pohon se kjo është shkelje e Nenit 196 (1) dhe (3) të LPP-së.

IV. Gjetjet e Gjykatës Supreme

25. Në vlerësimin e ankesës së paraqitur nga Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë dhe ankesës së paraqitur nga avokatët mbrojtës Ymer Osaj dhe Mexhid Sylja në emër të të pandehurit Besim Berisha, Gjykata Supreme e Kosovës vërtetoi siç vijon:

a. Ankesat e palëve në procedurë, përkatësisht të paraqitura nga prokurori dhe nga mbrojtja janë të pranueshme. Ankesat janë paraqitur në gjykatë kompetente në përputhje me Nenin 398 par 1 dhe brenda afatit në përputhje me Nenin 407 të KPPK-së.

b. Gjykata Supreme e Kosovës vendosi pas seancës së këshillimit dhe votimit pas shqyrtimit të mbajtur më 26 prill 2011 siç përshkruhet me Nenin 413, 411 dhe 420 të KPPK-së.

c. Ankesa e paraqitur nga Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë/Gjykata e Qarkut është **E PABAZUAR**.

d. Ankesa e paraqitur bashkërisht nga avokatët mbrojtës Ymer Osaj dhe Mexhid Sylja në emër të të pandehurit Besim Berisha është **E BAZUAR**.

26. Para vlerësimit të pjesëve të aktgjykimit i cili është kundërshtuar me këto ankesa, kolegji konsideroi *ex officio* se a është aktgjykimi kundërshtuar në përputhje me kushtet ligjore sipas Nenit 415 të KPPK-së.

27. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se dënimi kundër të pandehurit është i bazuar në vlerësimin e gabuar dhe jo të plotë të provave me vërtetim absolutisht të pasaktë të fakteve (Neni 366 LPP). Me përcaktimin e këtillë ky kolegji konsideroi një mori mospajtimesh dhe mospërputhjesh të gjetura në provat inkriminuese mbi të cilat është mbështetur gjykata e shkallës së parë të cilat prishin themelin e përgjithshëm faktik të

akuzave. Prandaj nevoja për të diskutuar rreth shkeljeve të pretenduara të procedurës është bërë fare e panevojshme.

28. Siç tregohet nga gjykata e shkallës së parë, me të cilën ky kolegji me respekt pajtohet nuk kontestohet se më 02 gusht 1999 rreth orës 18:00 dikush kishte trokitur në derën e shtëpisë së familjes M , që gjendet në rrugën Gj nr në Prishtinë. Ai njeri foli në gjuhën Serbe dhe kërkoi nga anëtarët e familjes M të largohen nga shtëpia deri në orën 20:00.

29. Nuk kontestohet as ajo se rreth orës 20:45 të njëjtën ditë, katër njerëzit shkuan te shtëpia e përmendur me kërkesë që të hapej dera ose në të kundërtën do ta hapnin derën me forcë. Me sa duket këta të fundit ishin personat e njëjtë që ishin paraqitur më herët gjatë ditës së njëjtë. Pasi familja M nuk u pajtua ta hapë derën vullnetarisht, katër njerëzit hynë me forcë. J M dhe V A ishin ndarë në njërën prej dhomave kurse M M ishte dërguar në kuzhinë me forcë. M M u rrah dhe përreth qafës ishte i lidhur me një mbulesë tavoline. Pasi sulmuesit u larguan nga vendngjarja J M shkoi në kuzhinë dhe e zgjidhi viktimën M M. Gjaku filloi t'i rridhte viktimës nga hunda dhe goja e tij. M M ishte i mbështetur kundrejt lavamanit dhe papritmas ai ra përtokë duke derdhur shumë gjak. J M pastaj thirri për ndihmë dhe KFOR-i erdhi në vendngjarje. Trupi i M M u gjet dhe KFOR-i bëri video incizimin e vendit të krimit. Trupi u dërgua në morgun e Klinikës Universitare në Prishtinë. Autopsia nuk u bë dhe trupi i të ndjerit iu dorëzua familjes për varrim.

30. Pas incidentit kur sulmuesit ikën, me sa duket J M ia tregoi KFOR-it hollësitë e incidentit bashkë me detajet e sulmuesve në bazë të së cilave KFOR-i arriti t'i kapë katër burra pas një dite më 03 gusht 1999. Ekzaminimi i shkresave të lëndës bënë të kuptohet se një dëshmi e tillë e dhënë nga J M nuk është në dispozicion. Prandaj është i paqartë çfarë lloj përshkrimi i kishte bërë J M për sulmuesit kur i kishte dhënë dëshminë KFOR-it.

31. Ditën e nesërme më 03 gusht 1999 J M identifikoi Besim Berishën (i cili gjatë identifikimit përdori identitet të rrejshëm pasi që emri i tij i vërtetë është Burim Dibrani) si njërin nga njerëzit që kishin hyrë në shtëpi ditën e djeshme më 02 gusht 1999. Në dëshminë e saj ajo përmendi siç vijon:

“ky njeri kishte një gips në krahun e djathtë siç mu duk mua. Katër gishtat e tij ishin të afruar bashkë me gips, kurse gishti i madh ishte me një gips të veçantë”.

32. Përveç gipsit të cilin faktikisht Besim Berisha e kishte në krahun e tij të majtë e jo në të djathtin siç e përmend dëshmitarja, tiparet e tjera të të pandehurit qartazi dallojnë nga ato të sqaruara nga dëshmitarja. Besim Berisha ishte rreth 19 vjeçar dhe relativisht mirë i zhvilluar në kohën e incidentit. Fotografite e marra të Besim Berishës që janë pjesë e shkresave të lëndës, qartë tregojnë mospajtim në mes përshkrimit të dhënë nga dëshmitarja dhe dukjes së të pandehurit.

33. Gjykata e shkallës së parë njohu praninë e mospajtimeve dhe kundërthënieve si të justifikueshme me këtë sqarim:


“Duhet të theksohet se në këtë ditë kritike, dëshmitarja kishte pësuar stres ekstrem, në situatë me rrezik për jetë, kështu që çdo hamendje sikur se ajo rreth anës së lëndimit nuk është vendimtare. Kjo njohje e tërësishme e dëshmitares korrespondon me shënimet mjekësore të të pandehurit që e bën dëshminë e J N edhe më të besueshme”.

34. Gjykata Supreme pajtohet me Gjykatën e Qarkut se mospërputhjet dhe kundërthëniet në dëshminë e dëshmitares mund të vijnë nga proceset natyrore psikologjike të perceptimit njerëzor, posaçërisht në dëshmitarët që kanë përjetuar ngjarje traumatike dhe të cilët për shkak të rrethanave procedurale është dashur t’i japin përshtypjet e tyre të ngjarjes para autoriteteve. Në këtë kuptim prania e kundërthënieve dhe mospërputhjeve nuk e skualifikon me *automatizëm* dëshminë e dhënë nga dëshmitarja, me kusht që ajo të jetë marrë në përputhje me dispozitat e procedurës penale. Në përgjithësi gjykata nuk duhet t’i trajtojë mospërputhjet e vogla në mes fakteve dhe dëshmisë së një dëshmitari të caktuar si diskreditim i vlerës së tyre dëshmuese si tërësi ku ai dëshmitar megjithatë ka treguar në mënyrë të mjaftueshme thelbin e incidentit në hollësi të kënaqshme. Mirëpo pa marrë parasysh nivelin e kundërthënieve dhe mospërputhjeve, kur çështja kryesore për përcaktimin e përgjegjësisë është identifikimi i të akuzuarit në ngjarjen kriminale, kundërthëniet përkitazi me elementet faktike nuk guxohet të mospërfillen lehtë. Në këtë rast identifikimi duhet të sqarohet deri në atë shkallë sa që provat të mos lejnë asnjë dyshim për praninë e këtyre elementeve. Përndryshe, gjykata duhet të veprojë në përputhje me parimin e interpretimit në favor të të akuzuarit (*favor rei*) i konceptuar edhe si standard drejtues i *vlerësimit të provave*.

35. Gjykata Supreme gjen se Gjykata e Qarkut nuk arriti të dëshmojë sa duhet lidhjen e Besim Berishës me veprat e kryera penale, veçanërisht në frymën e rrethanave të përshkruara më lart.

V. Përfundimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

Për arsyet e përmendura më lart, në përputhje me Nenin 420 (4) të KPPK-së Gjykata Supreme e Kosovës vendosi sikur në dispozitiv.



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
APn-KZ 176/10, 26 prill 2011

Kryetari i kolegjit:

Martti Harsia
Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtës:

Adnan Isufi
Këshilltar Ligjor

Anëtarët e kolegjit:

Maria Giuliana Civinini,
Gjyqtare e EULEX-it
EULEX Judge

Marije Ademi
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Republika e Kosovës Republika Kosovo
Anne Kerber
Gjyqtare e EULEX-it
SAKTËSINË E KOPJES SË KËTË GJYKIMI
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE
Punëtori i autorizuar
Ovlašćení radnik

Nesrin Lushta
Gjyqtare e Gjykatës Supreme